



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 1755 Prot.

Tiranë, më 22.06.2023

**Lënda:** Për realizimin e procedurave të regjistrimit të nxënësve në klasën e parë dhe të dhjetë.

DREJTORIVE RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSTAR \_\_\_\_\_

ZYRAVE VENDORE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE \_\_\_\_\_

Në zbatim të urdhrin nr. 31, datë 28.01.2023 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve arsimore në Republikën e Shqipërisë” si dhe në shkresën e MAS nr. 3285/3 prot., datë 14.06.2023 me lëndë: “Mbi saktësimin e periudhës së shërbimit të regjistrimeve në shkolla” kërkohet nga ana Juaj të merrni të gjitha masat e nevojshme duke monitoruar institucionet arsimore nën juridiksionin tuaj, për zbatimin e përcaktimeve ligjore gjatë periudhës së regjistrimit të nxënësve në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të lartë.

Institucionet e arsimit parauniversitare të vijojnë regjistrimin brenda afateve kohore të paracaktuara duke vlerësuar me prioritet aplikimet dhe kthim përgjigjet për personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Periudha kohore e përcaktuar për regjistrimin e nxënësve në klasë të parë dhe të dhjetë është parashikuar si më poshtë vijon:

- Për arsimin bazë, regjistrimet kanë filluar në datë 17 qershor 2023 dhe mbyllen në datë 30 qershor 2023.
- Për arsimin e mesëm, regjistrimet kanë filluar në datë 01 korrik 2023 dhe mbyllen në datë 15 korrik 2023.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rezarta ALLA



Adresa: Rruga “Aleksandër Moisiu” Përballë IKV, Tiranë

DRAP Tirane@arsimi.gov.al